



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr.141/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Nenad Lazić dhe Rafet Haxhaj anëtarë, si dhe me pjesmarrjen e zyrtares ligjore Arjeta Sylja, duke vendosur përkitazi me ankesën e BIRN-it dhe Internews Kosova, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Pejë, për shkak të vendosjes së billbordit në objekt dhe në rrugë publike, për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me 10.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e BIRN-it dhe Internews Kosova, ndërsa subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 1,100.00 (njëmijë e njëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të këtij vendimi **nën kërcënim të përmbarimit**.

A r s y e t i m

Me datën 06.10.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga BIRN-i dhe Internews Kosova, me të cilën pretendohet se në Pejë, në rrugën e spitalit brenda oborrit të çerdhes publike është vendosur baneri i kandidat për Kryetar të Komunes së Pejës nga subjekti politik LDK. Me këtë rast parashtruesit e ankesës theksojnë se është bërë shkelje e dispozitës së Nenit 33 pika b) i LZP-së.

Parashtruesit e ankesës si provë kanë bashkangjitur një video inqizim lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigje në ankesë të datës 08.10.2017, subjekti politik LDK, thekson se ankesa është plotësisht e pabazuar dhe si e tillë e njëjta duhet të hudhet posht për shkak se dëshmia e ofruar është e paqëndrueshme, për faktin se billbordi është vendosur në atë lokacion me leje të Komunës dhe është i dedikuar ekskluzivisht për reklamime të tilla gjatë fushatës, kryesisht reklamime politike. Kjo nuk ka të bëjë me shkeljen e pretenduar pasi që fotoja është e vendosur jasht objektit në një distancë të theksuar, pavarësisht që pala ankuese ka provuar ta minimizoj këtë distancë.

Si dëshmi ka bashkangjitur një fotografi ku shihet se është larguar posteri nga vendi ku ka qenë i vendosur.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e bazuar

Nga video inqizimi i ofruar si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se billbordi i kandidatit për kryetar komune nga radhët e subjektit politik LDK, është vendosur në rrugë publike, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton: *“Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave, njoftimeve, dhe slloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore në apo mbi rrugët publike.*

Duke u nisur nga arsyet e theksuara me lartë, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e subjektit politik LDK, është shkelur neni 33 pika (b) të LZP-së, pasi që billbordi i kandidatit për kryetar të Komunës së Pejës, nga subjekti politik LDK, është i vendosur në vendin i cili nuk është i dedikuar për vendosjen e billorreve.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret, se subjekti politikë Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se janë njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe për kundër këtij fakti billbordi i kandidatit të këtij subjekti politik është vendosur në objekt dhe në rrugë publike. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin që subjektit politik në fjalë, iu dha mundësia për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se brenda afatit të caktuar janë ndërmarrë veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes ashtu që kanë hequr billbordin nga vendi i palejuar, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës
ZL. Anr.141/2017 më datë 10.10.2017.

Kryesuesi i Panelit
Zyhdi Haziri



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.